



01 Nr. 050/26 Dt. 03.02.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 paragrafi f dhe g, të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe Bashkëfinancimit të nënshkruar ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe Caritas Kosova 01 nr. 636 datë, 02.10.2023 dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve për bashkëfinancim

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës për lejimin e mjeteve financiare për bashkëfinancim në realizimin e projektit: "Bashkëpunimi në fushën e edukimit dhe gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara arsimore në sistemin e rregullt arsimor", i cili bashkëfinancim është i bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit dhe Bashkëfinancimit të nënshkruar ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe Caritas Kosova 01 nr. 636 datë 02.10.2023, kështu që, për këtë qëllim Komuna e Prizrenit, në emër të bashkëfinancimit për këtë projekt (kësti i fundit), lejon mjetet financiare në shumë prej 5,060.00 € (pesë mijë e gjashtëdhjetë euro).
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Marrëveshja e Bashkëpunimit dhe Bashkëfinancimit të nënshkruar ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe Caritas Kosova 01 nr. 636, datë 02.10.2023.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i planifikuar buxhetor i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, mallra dhe shërbime.
4. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Caritas Kosova,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

